



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

**DOKUMENTI KONSULTATIV**

**Për projektligjin “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë”**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në kuadër të procesit të konsultimit të projektligjit mirëpret sugjerime nga:

- Personeli i Shërbimit të Jashtëm;
- Shtetasit shqiptarë të interesuar për t’u rekrutuar/pranuar në shërbimin e jashtëm;
- Institucionet shtetërore qendrore dhe vendore që kryejnë veprimtari në fushën e marrëdhënieve me jashtë.

**Kohëzgjatja e konsultimeve:**

Kohëzgjatja e konsultimit nga palët e interesuara është 20 ditë pune nga dita e publikimit në RENJKP, duke filluar nga data **2 gusht 2024** deri më **30 gusht 2024**.

**Si të përgjigjeni:**

Kontributi juaj me sugjerime konkrete, në kuadër të përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, të dërgohet nëpërmjet:

1. Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik duke klikuar në lidhjen e akteve të publikuara për konsultim nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si vijon: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Institucioni/113>
2. Në adresën e postës elektronike zyrtare të Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik të MEPJ: [konsultimipublik@mfa.gov.al](mailto:konsultimipublik@mfa.gov.al)

**Kontakti:**

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: [konsultimipublik@mfa.gov.al](mailto:konsultimipublik@mfa.gov.al)

**Datat dhe vendet e takimeve publike:**

Vendi: Në portalin e Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.  
Datat: 20 ditë nga shpallja e projektaktit për konsultim në RENJKP (2 deri 30 gusht 2024).

## Sfondi i propozimit legjislativ:

Qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë. Përgatitja e këtij projektligji erdhi si një domosdoshmëri për rregullimin e disa problematikave të hasura nga aplikimi i ligjit aktual për shërbimin e jashtëm, rregullimi i të cilave do i shërbejë një shërbim të jashtëm modern, i cili duhet t'i përgjigjet detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta dhe nga programet e qeverisë.

Periudha gati dhjetë vjeçare që ka kaluar nga ligji, i cili aktualisht është në fuqi ka bërë të nevojshëm rishikimin edhe të këtij akti me synim për t'ia përshtatur interesave të kohës. Projektligji ndër të tjera, reflekton krijimin e mundësisë për futjen në Shërbimin e Jashtëm të ekspertëve të fushës, duke respektuar detyrimet që kërkohen nga ligji nr.152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, por duke u njohur për efekt të llogaritjes së gradës diplomatike personale vitet e punës në Shërbimin e Jashtëm.

## Propozimet

Disa nga risitë që synohen me këtë projektligj janë:

- Projektligji rregullon me mirë fushën e kompetencave të Shërbimit të Jashtëm dhe raportet me institucionet kushtetuese, qendrore dhe vendore në fushën e marrëdhënieve me jashtë;
- Zgjeron hapësirat e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional në fushën e marrëdhënieve me jashtë, në përputhje me dinamikën e zhvillimeve në marrëdhëniet ndërkombëtare;
- Rregullon në mënyrë më të qartë procesin e emërimit dhe mbarimit të mandatit të kreut të misionit diplomatik dhe postit konsullor si dhe personelit diplomatik e konsullor;
- Forcon kriteret profesionale për rekrutimin e diplomatëve të karrierës mbështetur në nivelet e tyre akademike;
- Mundësohet përllogaritja për efekt të marrjes së gradës diplomatike personale të diplomatëve të karrierës të cilët në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë emëruar në misionet diplomatike dhe konsullore jashtë sistemit të karrierës diplomatike apo punojnë në organizatat ndërkombëtare;
- Sigurohet pastërtia dhe siguria e figurës së personelit të shërbimit të jashtëm;
- Për herë të parë futet si koncept ligjor krijimi i strukturës së Akademisë Diplomatike, e cila do të jetë jo vetëm në shërbim të përmirësimit profesional të diplomatëve, por edhe si një strukturë që në bashkëpunim me struktura të ngjashme homologe, do të ofrojë kurse trajnimi në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.
- Përcaktohet në mënyrë më të qartë përfshirja në misionet diplomatike dhe postet konsullore të personave jashtë karrierës diplomatike, si dhe dhënia e mundësisë që në përputhje me kriteret për pranimin në shërbimin civil të bëhen pjesë e shërbimit të jashtëm;
- Në funksion të krijimit të një hierarchie më racionale në strukturën e gradave diplomatike, janë forcuar kriteret për marrjen e tyre;

- Mirëpërcaktohen kriteret për trajtimin financiar të diplomatëve jashtë vendit, kjo për të krijuar një mjedis dinjitoz për punonjësit, të cilët ashtu si shërbimi ushtarak i detyrueshëm, kanë detyrë funksionale transferimin jashtë vendit, kurdo dhe kudo që ka nevojë institucioni.

## Pyetjet

Jeni të lutur të dërgoni sugjerimet dhe komentet për projektligjin e shpallur për konsultim publik.

Mirëpresim kontributin Tuaj.